

**KURS RRETH SUPERVIZIMIT TE SIGURUESVE BAZUAR NE  
PARALAJMËRIMIN E HERSHEM DHE AFTËSINË PAGUESE**

# **MODULI 1 –**

**SIGURIMI JOJETË**

**PARIME BAZË**

**RODNEY LESTER  
SERAP GONULAL  
BANKA BOTËRORE**

**20 NËNTOR 2006**

## NJË VËSHTRIM I KONCEPTVE BAZE TE KONTABILITETIT

1. Hyrjet e kontabilitetit ndahen ne 2 klasa te përgjithshme – zërat qarkullues dhe zërat stoqe. Zërat stoqe janë ose asete qe prodhojnë te ardhura ose nga obligimet financiare (borxhet) qe gjenerojnë këto asete – ato pasqyrohen ne bilanc. Zërat qarkullues lindin nga aktivitetet tregtare te ndërmarrjeve dhe quhen te të ardhura dhe shpenzime – ato pasqyrohen ne pasqyrën e te ardhurave (e njohur ndryshe edhe si pasqyra e fitimeve dhe e humbjeve). Vlerat qe pasqyrohen ne pasqyrën e te ardhurave dhe ne bilanc njihen si llogari.
2. Asetet transformohen ne shpenzime kur ato konsumohen dhe quhen **debite**. Te ardhurat bëhen detyrime (domethënë u rriten atyre qe financojnë biznesin) kur krijohen dhe quhen **kredite**.
3. Bazat e te dhënave ne te cilat regjistrohen rekordet origjinale te transaksioneve njihen si ditarë llogarish. Bazat e te dhënave, ne te cilat regjistrohen dhe përmbliidhen te njëjtat lloje transaksionesh, njihen si libra te llogarive. Llogarite janë saldo te nivelit te larte te librave te llogarive (p.sh., saldoja e te gjithë debitorëve tregtare).
4. Meqenëse ciklet e operimit janë shpeshherë me te gjate se sa ciklet e kontabilitetit, te gjitha qarkullimet e kesh-it qe rezultojnë nga një transaksion shpesh nuk ndodhin ne momentin qe llogarite janë balancuar dhe bilancet e debiteve ose te krediteve duhen krijuar për te përfaqësuar gjendjen e akumuluar te transaksionit (domethënë vlerat prezente te qarkullimeve te kesh-it nga transaksionet qe do te futen ne periudhat e ardhshme kontabël).
5. Çdo kredit duhet te kundërbalancohet nga një debit ose nga një kredit negativ dhe çdo debit te balancohet nga një kredit ose debit negativ. Për shembull, një prim (një zë llogarie krediti) rezulton ne krijimin e aseteve (domethënë te zërave te llogarisë se debitit) ne formën e kesh-it, te depozitave bankare apo te të hyrave te agjenteve ose te brokerave.
6. Ilustrimet e bilancit dhe e pasqyrës se te radhuarve për një sigurues jojetësor janë dhënë ne Aneksin 1.

## CIKLI OPERUES I SIGURACIONIT TE ZAKONSHËM

7. Policat e përgjithshme te sigurimit zakonisht shkruhen për një vit për te mbuluar humbjet qe mund te ndodhin gjate atij viti. Ne fund te vitit polica mund te mos rinovohet dhe raporti ndërmjet kompanisë dhe te siguruarit përfundon, përveç kërkesave te papaguara.

8. Komisionet për agjentet ne sigurimin e përgjithshëm paguhen njëherë një vit. Ato tentojnë te jene rreth 15% e primit çdo vit, por ,mund te jene me te ulëta për klasat e detyrueshme dhe me te larta linjat e lidhura me kreditin. Ne tregjet eficente shpenzimet operative janë zakonisht rreth 15% te primit bruto te shkruar.
9. Disa linja pakice siç është sigurimi i motorik mund te rishiten çdo gjashte muaj ne përputhje me policat e primit gjashte mujor dhe se bëhen shume manovrime për zotërimin e pjesës se tregut nëpërmjet ndryshimit te normave, te zhvlerësimit, etj. Nga ana tjetër, sigurime te caktuara komerciale mund te shiten si kontrata shume vjeçare.

### **SHUMAT KONTABEL TE PARASHIKUARA SI REZERVE<sup>1</sup> DHE REZERVAT**

10. Ne terminologjinë e kontabilitetit shuma e parashikuar si rezerve është një shume e ruajtur për detyrim qe njihet ose qe mund te parashikohet ne mënyrë te arsyeshme. Rezervat janë shuma qe planifikohen për ngjarje qe mund te ndodhin, por qe ka një shkalle me te madhe pasigurie lidhur me ndodhinë apo me ashpërsinë me te cilën ajo mund te ndodhe - ne vartësi te regjimit te taksave ato mund te krijohen nga te ardhurat përpara ose pas taksave.
11. Një shume e parashikuar si rezerve ne sigurim e përgjithshëm është një zë ne ndarjen bilancit për detyrimet qe përfaqëson shumen qe nevojitet për te paguar kërkesat e siguracionit si rezultat i aksidenteve te palës se pare apo te veprimeve ligjore te palës se trete qe ndërmerren kundër te siguruarit. Këto raste kërkesash mund te kenë ndodhur tashme apo mund te ndodhin ne te ardhmen. Detyrimet për rastet te cilat kane ndodhur tashme quhen shumat e parashikuara për kërkesat. Kërkesat e ardhshme do te paguhen nga shumat e parashikuara qe njihen si shumat e parashikuara te primit te pafituar apo shumat e parashikuara te riskut te paskaduar.

### **PRIMET DHE REZERVA E E PRIMIT TE PAFITUAR**

12. Kur një police shitet, primi i plote qe do te paguhet nga i siguruari quhet prim i shkruar. Kështu primi bruto i shkruar, i cili është shuma e te gjithë primeve te shkruar, përbën një matje te suksesit te shitjeve te kompanisë.
13. Kompania zakonisht dërgon një pjese primi pranë kompanive te risigurimit për t'u mbrojtur kundrejt humbjeve ekstreme, duke e lënë primin neto te shkruar ne librat e vet. Primi neto i shkruar ne raport me kapitalin dhe tepricën është matja e fuqise (ose aftësisë paguese) te një kompanie te sigurimit te përgjithshëm. Përgjithësisht një kompani nuk duhet te shkruaje me shume se sa 2 deri ne 4 here kapital dhe teprice, por kjo do te ndryshoje sipas linjës se biznesit. – sa me te paqëndrueshme qe te jene rezultatet e klasës se biznesit, aq me shume kapital dhe teprice ( te quajtur kapital ekonomik) duhen alokuar për atë klase për te

---

<sup>1</sup> Provizionet

- kompensuar riskun shtese. Fuqia investuese e lejueshme është e lidhur edhe me masën absolute të kapitalit dhe të tepricës. Një kompani e vogël nuk ka një shpërndarje të gjere të mjaftueshme të riskut dhe të një numri të madh të policave në mënyrë që të jete në gjendje të mbështetet në përvojën e “mesatare”.
14. Primi neto i shkruar mbulon një periudhë të caktuar kohore e cila ndoshta shtrihet gjatë periudhave të ndryshme kontabël. Për këtë arsye primi neto i shkruar duhet amortizuar gjatë të gjithë periudhës kohore. Pjesa e cila aplikohet në një periudhë të caktuar kohore është konsideruar si “**i fituar**” në këtë periudhë. Prandaj primet neto të shkruara ndahen në prime të fituara deri tani dhe pjesa tjetër e primit i cili është konsideruar si “**i pafituar**”.
  15. Kompania e vendos mënjane këtë prim të pafituar duke krijuar në këtë mënyrë një shumë të parashikuar që quhet shuma e parashikuar si rezerve e primit të pafituar.
  16. Në ditën e pare, në teori, do të ketë një shumë e parashikuar si rezerve e primit të pafituar e krijuar nga kompania e barabarte me 100% të primit (neto-ja e kostove të posedimit dhe kostove administrative). Në praktike shumat e parashikuara (dhe rezervat) llogariten vetëm në fund të periudhave kontabël.
  17. Meqenëse këto prim-e janë për t’u aplikuar në muajt e ardhshme ata do të jene pjesë e të ardhurave në këta muajt. Me fjale të tjera, 1/12 e prim-it do të fitohet çdo muaj dhe kjo shumë do të shkojë për në të ardhurat e kompanisë ndërkohë që koha kalon. Rezerva e prim-it të pafituar zakonisht llogaritet në baze të proporcionalitetit. Për shembull, një prim për një vit me datën 1 Tetor 2006 do të ishte 3/12 i fituar në vitin 2006 dhe 9/12 do të ishte një rezerve primi e pafituar në fund të vitit. Kjo 9/12 do të fitohej në vitin 2007.
  18. Nëse kompjuterat janë të disponueshëm, mënyra më e mire për të alokuar primet ndërmjet të fituarës dhe të pafituarës është të veprohet në baze ditore (1/365). Në kohët e shkuara dhe në ambientet e pakompjuterizuara mënyra më e zakonshme do të ishte në baze mujore ose gjysme mujore (metoda e 1/24-s).

**Primi i fituar** është i barabarte me:

- (a) primet e shkruar (neto-ja e risigurimit dhe një fond për kostot e shpërndarjes dhe fikse), plus
  - (b) rezervën e primit të pafituar në fillim të periudhës, minus
  - (c) primin e pafituar në fund të periudhës.
19. Me fjale të tjera, primet që futen në pasqyrën e të ardhurave janë (a) ato që janë marre, plus (b) ato që ishim marre në periudhën e mëparshme, por që e kishim vënë mënjane tek rezervat e primit të pafituar për ta përdorur tani, minus (c) ato prime që në duhet t’i vendosim mënjane për t’i përdorur në periudhën pasardhëse

2005	2006	2007
.....	.....	.....
	→	
		→

**Pikat përfaqësojnë aksidentet.**

**Shigjetat përfaqësojnë periudhën kohore që mbulohet nga primet.**

**Primi paguhet në fillim të shigjetës, por që duhet të kundërbalancojë çdo aksident që ndodh gjatë periudhës së primit. Kështu që vetëm një pjesë e atij primi mund të përfshihet në të ardhurat në vitin e paguar. Pjesa tjetër mbahet në një rezervë të fundit të vitit për të paguar ato kërkesë e që bëhen ndërmjet fundit të vitit dhe pagesës së primit pasardhës.**

20. Një rritje në shumën e parashikuar si rezerve e primit të pafitur përbën një shpenzim të kompanisë kur llogaritet fitimet. Nëse rezerva ka qenë e lartë dhe tani është ulur, çlirimi i shumës së parashikuar si rezerve do të jetë një shpenzim negativ dhe do të rrisë fitimet.
21. Në periudhat e ardhshme, primi i pafitur do të jetë e gjitha ajo shume që është fituar për policat e trashëguara nga viti i mëparshëm kontabël. Kështu, shumën e parashikuar si rezerve e primit të pafitur është, në të vërtetë, rezerva për kërkesat e ardhshme të siguracionit.
22. Shembull: një prim për një vit të plotë paguhet më 1 Korrik. Primi është 100 njësi, komisioni është 15 njësi dhe kosto e menaxhimit e sigurvearit është 15 njësi për vit. Rezerva e primit të pafitur në fund të vitit, bazuar në primet neto të komisioneve, është  $(100-30)/2 = 35$ .
23. Meqenëse shumën e parashikuar si rezerve e primit të pafitur shërben për pagimin e kërkesave të ardhshme, nuk është gjithnjë e pranueshme për një kompani ta llogarisë këtë rezervë thjesht si një përqindje të primeve që merren. Nëse është regjistruar një bllok i keq biznesesh dhe humbjet pritet të kalojnë atë përqindje të primeve të rezervës së atëhershme, atëherë rezerva duhet rritur respektivisht – shumën shtesë quhet një shumë e parashikuar si rezerve për riskun e paskaduar (ose rezerve nëse kërkesat shtesë janë shumë të pasigurta).

## **KËRKESAT DHE SHUMAT E PARASHIKUARA SI REZERVE PER KËRKESAT**

24. Ne seksionin e fundit ne pamë primet dhe se si kompanitë krijojnë rezervat e primeve te pafituara ne mënyrë qe primet a pafituara akoma do te jene te disponueshme ne te ardhmen për te paguar kërkesat e ardhshme.
25. Tani ne do te shohim shuma te tjera domethënëse rezerve te një kompanie sigurimesh te përgjithshme. Këto janë shumat e parashikuara si rezerve për kërkesat qe mbahen për te paguar kërkesat te cilat kane ndodhur tashme.
26. Kompanitë e përgjithshme te sigurimeve mund te pësojnë shpenzime te mëdha ne pagimin e kërkesave. Prandaj kompanitë përfshijnë kostot e investigimit dhe zgjidhjes se kërkesave si pjese e totalit te kërkesave.

### **Procesi i Kërkesave**

27. Ka disa faza te ndryshme ndërmjet ndodhjes se një aksidenti dhe pagimit te kërkesës. Një kompani sigurimi jojetësor mund edhe ta quaje kërkesën një humbje.

(1) – Nga pikëpamja e kompanisë se sigurimeve dhe e doktrinës se kontabilitetit, kërkesa shkaktohet kur ndodh një aksident apo një dëmtim.

(2) Kërkesa raportohet pranë kompanisë se sigurimeve. Kjo mund te ndodhe ditën e aksidentit ose mund te duhen disa muaj, madje edhe disa vite. Për shembull, kërkesa e siguracionit për një ngarkese te transportuar ne një kontejner do te kërkonte me shume kohe. Kontejneri do te duhej te transportohej ne anën tjetër te botes përpara se ai te hapej dhe te zbulohej dëmtimi. Letrat do t'i dërgoheshin transportuesit dhe me ne fund kompanisë se sigurimeve. Ne rastin e sigurimit te detyrimeve do te duheshin disa vite përpara se e efekti i derdhjes se një substance kimike do te njihej dhe detyrimi t'i atashohej kompanisë se sigurimit.

Shembull: Ne SHBA një qytet bëri një kërkesë për një rrjedhje kimike nga një vend-depozitim kimikatesh. Kimikatet kishin qene depozituar aty para 20 vitesh dhe kompania nuk e kishte siguruar qytetin për te paktën 15 vite. Llojet e sigurimit kur duhet një kohe e gjate për zgjidhjen e kërkesave konsiderohen si afatgjata.

(3) Kërkesa përpunohet, domethënë, informacioni mblidhet. Zakonisht kjo nuk kërkon me shume se një jave ose dy për sigurimin e automjeteve, por do te kërkonte vite ne disa raste detyrimesh sidomos nëse ka raste gjyqësore te përfshira apo kur një gjendje mjekësore duhet te stabilizohet.

(4) Kërkesa aprovohet ose rrezohet.

(5) Kërkesa paguhet – ne kompanitë e mëdha mund te duhet një jave për te përgatitur çekun dhe për ta nisur atë

28. Kompania e sigurimit ka sasi te ndryshme informacioni ne çdo faze te procesit te kërkesave.
29. Ne rastet kur ka ndodhur aksidenti, por qe nuk është raportuar, kompania nuk disponon fare informacion. Kompania, madje, as nuk e di se aksidenti ka ndodhur. Megjithatë aksidenti ka ndodhur dhe prandaj kompania ka një detyrim. Ne këtë faze, kërkesa është “bere, por nuk është raportuar” apo IBNR (Te Ndodhura por te Paraportuara).
30. Kompania mund ta dije se ka një humbje, por nuk ka detajet. Cilat kane qene rrethanat e aksidentit? A mbulohet prona nga polica e sigurimit? A ka risigurim? Çfarë mendon risiguresi? A mund te ketë përfshirje te ndonjë mashtrimi? Sa ka qene humbja? Kërkesat e përcaktuara janë ne proces.
31. Kërkesa aprovohet, por nuk paguhet. Ne këtë pike kohore kompania ndoshta ka te gjithë informacionin qe ajo mund te ketë ndonjëherë.
32. Shumat e parashikuara si rezerve për kërkesat ose për humbjet, bazuar ne ciklin e kërkesave, janë si me poshtë vijon:
- (a) Shumat e parashikuara si rezerve për ato qe kane ndodhur, por qe janë te paraportuara (IBNR)
  - (b) Shumat e parashikuara si rezerve për kërkesat ne proces  
Shumat e parashikuara si rezerve për kërkesat e aprovuara por qe nuk janë paguar akoma (domethënë, detyrimi i pagimit te kërkesave).

### **Vlerësime te Rastit**

33. Për shumicën e klasave me afatshkurtër te sigurimit ku kërkesat zgjidhen relativisht shpejt, vlerësimi i dhënë nga zgjidhësi i kërkesave do te jete relativisht i sakte dhe i drejte dhe se mund te fitohet një vlerësim i arsyeshëm i shumave te parashikuara si rezerve për kërkesat duke mbledhur vlerësimet për zgjidhjen e dosjeve te kërkesave individuale. Shqetësimi qe mbetet janë rastet e IBNR (Te Ndodhura por te Paraportuara) ( te trajtuara me poshtë).
34. Kur kërkesat kane nevojë për një kohe te gjate për te zgjidhur vlerësimin e rasteve (klasa afatgjata si është rasti i marinës dhe i detyrimit) ne fillim te fazave te hershme kemi te bëjmë, ne rastin me te mire, me prezumime te argumentuara. Ne këto raste shumat e parashikuara si rezerve për kërkesat (përfshirë këtu edhe IBNR -Te Ndodhura por te Paraportuara) shpesh përcaktohen duke përdorur metodat aktuale (ekspertize e sigurimeve) bazuar ne modelet e zhvillimi te kërkesave te viteve te mëparshme. Kërkesat e mëdha qe janë te zhvilluara ne një mase te konsiderueshme (le te themi me shume se 5 vite) mund te vlerësohen individualisht për te plotësuar procesin aktuar, pra te ekspertizës se sigurimeve.

## Përqasjet Aktuare

35. Për klasat me afat te gjate ekspertet e sigurimeve bëjnë një përdorim te gjere te zhvillimit te humbjeve ose te statistikave trekëndore për te treguar evoluimin e vlerësimeve te humbjeve faktike nisur nga ku janë raportuar ato ne fillim dhe deri kur ato janë zgjidhur përfundimisht. Statistikat nga kjo analize mund te përdoren për dhënë një vlerësim më ekzakt te detyrimit final te kompanisë dhe, ne këtë mënyrë, do te japin një shifër me ekzakthe te kërkesave ne çdo vit.
36. Ne tabelën e dhënë me poshtë Kolona numër 1 tregon vlerësimin e humbjeve ne fund te vitit ne te cilin ato janë shkaktuar (p.sh., ne fund te vitit 1996 humbjet e shkaktuara atë vit janë vlerësuar te jene 80). Kolona 2 tregon vlerësimet e atyre humbjeve ne një vit me vonë (p.sh., humbjet e shkaktuara ne vitin 1996 vlerësohen te jene 90 një vit me vonë, qe do te ishte fundi i vitit 1997). Ne këtë shembull te gjitha humbjet e vitit 1996 duket se janë zgjidhur ne vitin e 7<sup>te</sup> meqenëse shifra e kërkesave mbetet konstante ne vijim.

### KRIJIMI I VLERËSIMEVE TE HUMBJEVE PËR DHJETE VITE DUKE NISUR ME VITIN E HUMBJEVE 1996

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1996	80	90	91	89	89	90	88	88	88	88
1997	82	89	89	86	91	92	92	91	88	
1998	82	90	89	94	93	91	92	91		
1999	86	85	89	87	85	87	86			
2000	102	108	107	105	108	102				
2001	97	97	98	95	96					
2002	98	97	99	98						
2003	100	102	101							
2004	102	100								
2005	101									

37. Aty ku vlerësimet e kostos përfundimtare te një kërkesë janë te pabesueshme apo te vështira për te formuar një trekëndësh bazuar qarte mbi kërkesat e paguara (ose pjesërisht te paguara) shpesh mund te përdoren ne preference ndaj te dhënave te zhvillimit te plote te humbjeve (domethënë, kërkesat e paguara deri tani plus kërkesat e papaguara).
38. Analiza mund t'i nënshtrohet disa përqasjeve. Kolonat krahasohen me kolonat. Ne këtë shembull ne vërejmë se për vitet 1996, 1997 dhe 1998 vlerësimi i humbjes ne fund te vitit te pare është rritur me rreth 10% pas një viti. Kjo do te thotë se shumtat e parashikuara si rezerve kane qene zvogëluar me 10% dhe kjo mund te dëmtonte aftësinë paguese te kompanisë. Diçka mund te mos ketë funksionuar me tekniken ose me përdorimin e saj. Ne vitet e mëvonshme kjo është riparuar.
39. Rreshtat krahasohen me rreshtat. Ne këtë shembull ka pasur një rritje domethënëse nga viti 1999 ne vitin 2000. Kjo mund te ishte një sinjal qe diçka

nuk funksionon. Kjo mund të ketë ndodhur sepse mund të jete shkruar një numër i madh produktesh të këqija duke u orientuar drejt nevojës për një ndryshim në strategjinë e marketingut. Kjo mund të ketë ndodhur edhe sepse kompania kishte shkruar shumë me tepër në një përpjekje për të fituar pjese të tregut.

40. Diagonalet krahasohen me diagonalet. Në këtë shembull kishte një rritje në diagonalen që shkon nga viti 2001. Vlerësimi i kërkesave të vitit 2000 shkoi nga 102 në 108, vlerësimi i kërkesave të vitit 1999 shkoi nga 85 në 89 e kështu me radhë. Me fjale të tjera, diçka ndodhi në vitin 2001 që e detyroi kompaninë të rivlerësojë të gjitha kërkesat e saj të papaguara. Një shembull i një ndodhie të tillë do të ishte një rast gjyqësor që përcakton limite të reja lidhur me shlyerjet për kërkesat e detyrimeve.

### **Rezerva IBNR**

41. Ka një numër teknikash të përdorura për të vlerësuar shumat e parashikuara si rezerve për IBNR (Te ndodhura por të paraportuara) për klasat me afat të shkurtër dhe në disa vende rregulloret aplikojnë një shtese përqindje fikse ndaj vlerësimit të rasteve, të cilat mund të ndryshojnë sipas klasës së biznesit. Për shembull, në terma shumë të thjeshtëzuar:

- (a) Sa kërkesa raportohen çdo ditë? Sa kohe duhet mesatarisht që një kërkesë të raportohet? Nëse duhen 6 ditë për të raportuar një kërkesë, dhe ndërkohë janë 15 kërkesa që raportohen çdo ditë, atëherë në çdo kohe do të kemi  $6 \times 15 = 90$  kërkesa të paraportuara akoma. Nëse kërkesa mesatare është 100 atëherë IBNR (te ndodhura por të paraportuara) do të jete  $90 \times 100 = 9000$ .

Këta faktorë do të variojnë sipas llojit të biznesit. Ata do të variojnë edhe sipas periudhës së vitit meqenëse njerëzit do të jenë të zënë me pushime në periudha të caktuara. Ato variojnë edhe sipas rajonit. Në fushat ku një zyre afër është shumë me e lehtë për të raportuar një kërkesë se sa në një zonë të thellë.

- i. (b) Kompania do ta dije se IBNR (Te ndodhura por të Paraportuara) në vitet e shkuara me se fundi ka funksionuar duke arritur shifrën X % të primit të fituar për periudhën e dhënë ose Y % e vlerësimeve të rasteve në ditën që llogarite balancohen. Ajo pastaj mund të vlerësonte shumën e parashikuar si rezerve bazuar në këtë eksperience të mëparshme.

Përsëri këta faktorë do të ndryshojnë sipas linjës së biznesit, periudhës së vitit, vendndodhjes, etj.

- (c) Kompania do të vlerësonte faktorin IBNR (Te ndodhura por të Paraportuara) bazuar në raportet e humbjes (te cilën në do ta

diskutojmë ne sesionet pasardhëse).

- ii. (d) Një vëmendje e veçante duhet kushtuar për rastet e njohura që nuk ndodhin çdo vit. Për shembull, nëse një termet do të kishte rënë me 30 Dhjetor, kompania do të kishte përfshirë kërkesat rezultuese të pritshme si elemente esenciale në shtim të IBNR (Te ndodhura por të Paraportuara) që do të ndodhte në një vit të zakonshëm.

### **Likuiditeti**

42. Në sigurimin e përgjithshëm shumica e afateve të kërkesave janë zakonisht të shkurtër kështu që, sipas këtyre policave, ato do të paguheshin brenda 12 muajve ose ndoshta më shpejt. Prandaj likuiditeti merr një rëndësi të veçante. Prandaj një raport i rëndësishëm në funksion të ekzaminimit të këtyre kompanive është (asetet likuide) ndaj (shumave të parashikuara si rezerve për kërkesat plus primin e pafitur, ose shumat teknike të parashikuara si rezerve).
43. Në vendet në zhvillim ku nuk ka tregje të aseteve likuide rregulloret shpesh imponojnë në raport minimal likuiditeti (zakonisht depozita bankare të mire-diversifikuara) prej, le të themi, 20 % të shumave teknike të parashikuara si rezerve.

### **Kërkesat e Aprovuara Por Akoma të Papaguara**

44. Kjo pagese është thjesht një shume e të gjithë kërkesave të cilat janë miratuar, por që për ato nuk është lëshuar akoma ndonjë çek.
45. Kjo është një llogari e lehtë për t'u bërë, megjithëse për rregullatorin përbën një zë të rëndësishëm për ta shikuar. Kompanitë, të cilat janë në vështësi, nuk kanë kesh, kështu që ato vonojnë pagimin e kërkesave. Prandaj, një rritje ose një keq-llogaritje e kësaj llogarie është një shenje paralajmëruese.

### **Kontrolli i Kërkesave**

46. Kontrollimi i kërkesave është një problem madhor për kompanitë e sigurimit të përgjithshëm. Kërkesat në rastin e sigurimit të përgjithshëm bazohen në parimin e dëmshpërblimit: kompania rimbursos të siguarin për humbjet e tij ekonomike. Kjo le shumë hapësirë për mosmarrëveshje ndërmjet siguresit dhe të siguarit. Njerëzit mund edhe t'i tërheqë ideja që të zmadhojnë humbjet e tyre si dhe siguresit që janë në vështësi të shmangin shlyerjen e kërkesave legjitime. Kompanitë duhet, në këtë mënyrë, të shpenzojnë shumë kohë për të përcaktuar nëse kërkesa është legjitime dhe nëse përmasa e kërkesës është e përligjur dhe shpesh janë të nevojshëm mekanizmat e veçante të mbrojtjes së konsumatorit.
47. Kompanitë hyjnë në kategorinë e bizneseve që bëjnë kontrollin të kostove për

kërkesat. Nëse ata nuk kontrolloje kostot, atëherë do te duhet te rriten prim-et dhe, për pasojë, do te bjere numri i klientëve. Për shembull, ata bëjnë kontrata me pikat e riparimit te automjeteve dhe luajnë një rol te madh ne futjen e teknikave te reja siç kombinimi kompjuterik i bojërave te automjeteve, etj.

### **Impakti i Kontabilitetit mbi Përcaktimin e Normës se Primit**

48. Kompanitë e sigurimit te përgjithshëm duhet qe, ne mënyrë konstante, te monitorojnë statistikat e humbjeve te tyre. Është pikërisht eksperiencia e humbjeve qe përcakton me se shumti se si po ecën kompania dhe se sa duhet te jene primit.
49. Një kontabilist duhet te përgatisë raportet e tij ose te saj me shifrat dhe vlerësimet me te mira te disponueshme. Kontabilisti mund te rikthehet dhe t'i ndryshoje shifrat e tij çdo muaj dhe çdo informacion i ri do te ndikojë mbi pasqyrën pasardhëse qe ai ose ajo do te përgatisë.
50. Prandaj, nëse shumat e parashikuara si rezerve janë shume te larta ne vitin 2006, atëherë fitimet ne këtë vit do te jene me ulëta ne pasqyrën vjetore se sa ishin ne terma ekonomike Kur te zbulohet ne vitin 2007 se shuma e parashikuar si rezerve ka qene tepër e larte, atëherë ajo do te ulet. Kjo bën qe fitimet ne vitin 2007 te dalin me te larta se sa shifra ekonomiksht e sakte.
51. Kur menaxhimi vendos nëse duhet te rrisë primit, atëherë ai ka nevojë për një seri shifrash te sakta dhe jo për një seri vlerësimesh. Prandaj menaxhimi do te axhustojë ne mënyrë konstante numrat e kërkesave te bëra për vitet e shkuara.

Shembull:

i. Viti	humbjet e raportuara		Humbjet faktike te vlerësuara ne vitin e 4-t
	a. Ne pasqyrën	b. Vjetore	
ii. 1	75		65
iii. 2	70		70
iv. 3	75		75
v. 4	73		80

52. Ne këtë shembull humbjet e raportuara ne pasqyrën vjetore, bazuar ne vlerësimet me te mira te disponueshme ne atë kohe, do te tregonin se humbjet janë konstante ndërmjet shifrave 70 dhe 75 çdo vit. Duke krahasuar dy kolonat ne shohim se zmadhimi ne vitin 1 shtoi fitimin me 10 ne vitin e dyte. Me ane te axhustimit te numrave te të dhënave te menaxhimit për informacionin e disponeueshëm ne një date te mëvonshme, organi i menaxhimit duhet te shqetësohet pasi humbjet po rriten ne mënyrë te qëndrueshme dhe kjo mund te tregojë se kërkohet një rritje e normave te primeve.

53. Prim-et e sigurimit, veçanërisht për klasat e detyrueshme, janë politikisht te

ndjeshme. Si rregull i përgjithshëm, ambienti rregullator duhet të ndërhyjë sa më pak që të jetë e mundur në treg, por të përpiqet të sigurojë se normat e vendosura nga sigurvearit janë të mjaftueshme, jo të pamundshme dhe jo diskriminuese në mënyrë të padrejte.

### **RAPORTE TË RËNDËSISHME OPERATIVE**

54. Tre raportet kyçe të operimit janë raporti i humbjeve, raporti i shpenzimeve dhe raporti i kombinuar.

#### **Raporti i Humbjes (ose Raporti i Kërkesave)**

55. Për një kompani sigurimesh të përgjithshme një kërkesë konsiderohet si një humbje.

56. Raporti i humbjes, i njohur edhe si raporti i kërkesave, krahason humbjet e kompanisë me primet e kompanisë.

57. Ky raport shpeshherë keq-llogaritet dhe, për pasoje, çon në shumë konfuzion. Raportet e ulëta të humbjeve zakonisht tregojnë se raportet janë llogaritur gabim ose normat e shpenzimeve janë të larta.

58. Problemi shfaqet në përzgjedhjen që ka të bëjë me atë se cilat kërkesa (ose humbje) dhe prime të përdoren. Kontabiliteti duhet të reflektojë çfarë ka ndodhur në një periudhë të dhënë specifike në bazë të të drejtave të konstatuara; prandaj, ky raport përdor kërkesat e bëra ndaj primeve të fituara.


59. **Kërkesat e bëra** janë ekuivalente me:

Kërkesat e paguara gjatë periudhës, minus shumat e parashikuara si rezerve në fillim të periudhës, plus shumat e parashikuara si rezerve për kërkesat në fund të periudhës.

60. **Primet e fituara** të përdorura në këtë raport janë ato pjesë të primeve, të cilat do të alokoheshin për periudhën kohore në fjalë. Ato janë ekuivalente me:

Primet neto të shkruara, minus primin e pafituar në fund të periudhës, plus the primin e pafituar në fillim të periudhës.

### Alokim i Humbjeve tek Viti net e Cilin Ato Janë Shkaktuar



- ..... Humbjet e shkaktuara
- ▭ Humbjet e paguara ne vitin 1997
- ▭ (a) Humbjet e paguara ne vitin 1998
- ▭ (b) Humbjet e paguara ne vitin 1999

### Përmasa e Raportit të Humbjes

61. Çfarë përmasë duhej të ishte raporti i humbjes? Numri do të variojë, por diapazoni në tregjet efektivisht konkurruese zakonisht është 60% – 80%. Raporti i humbjes do të variojë sipas linjës së biznesit dhe, për pasojë, nga njëra kompani në tjetrën në vartësi të biznesit të saj miksi.

Shembull: Nëse një kompani siguron satelitë, atëherë raporti i humbjes për vite me radhe mund të jete zero, ashtu siç mund të jete pastaj 1,000% nëse një satelit dështon.

62. Nga ana tjetër, sigurimi i automjeteve zakonisht shkakton kërkesa brenda një diapazoni dhe frekuence relativisht të vogël në çdo vit (në vartësi të gjendjes së motit dhe të rrugëve).

63. Një kompani zakonisht do të regjistrojë disa linja biznesi. Për pasojë pasiguria e raportit të përgjithshëm të humbjes së kompanisë do të varet në atë se çfarë kombinim produkti ajo regjistron.

64. Siç është vërejtur, përmasa e raportit të humbjes është edhe një funksion i shpenzimeve të kompanisë duke përfshirë komisionet e agjenteve.

Shembull: Kur kompania përcakton primin, ajo konsideron të gjithë faktorët përfshirë edhe shpenzimet. Nëse komisionet janë 15% dhe shpenzimet e tjera 15% atëherë kompanisë do t'i duhet të paguaje 70% të kërkesave (duke mos marrë parasysh të

ardhurat e investimit).

65. Megjithatë, nëse për çfarëdo arsyeje shpenzimet rriten, atëherë edhe primit do te duhet te rriten. Kompania akoma ka nevojë për shifrën 70 njësi që te paguaje kërkesat. Primi mund te duhet te rritet ne shifrën 110 për te mbuluar shpenzimet. Raporti i kërkesave shkon nga  $70/100 = 70\%$  ne  $70/110 = 63.6\%$ .
66. Pra, raporti i kërkesave lidhet shpesh ne mënyrë inverse me shpenzimet. Sa me te larta te jene shpenzimet, veçanërisht norma e komisionit, aq me e ulet pritet te jete raporti i kërkesave.
67. Ky është një shembull i rëndësishëm sepse ai tregon se një raport i ulet kërkesash nuk do te thotë domosdoshmërisht se kompania po ecën mire. Mund te ndodhe qe kompania me një raport te larte humbje është, ne fakt, me eficientja dhe me e mire-menaxhuara. Raporti i ulet i kërkesave mund te jete një kompani e menaxhuar dobët e cila është ne vështërsi serioze.
68. Ne linjat e biznesit ku shteti kontrollon normën e primit, rritja e normës do te jete e domosdoshme herëpashere ne mënyrë qe kompanitë te nxjerrin fitime. Megjithatë, nëse rritja e normës është me shume se sa është e domosdoshme, pjesa ekstra mund t'u kaloje komisioneve te agjenteve ndërkohe qe kompania përpiqet qe te përfitojë me shume biznes. Kjo mund te jete e mire për agjentet, por jo gjithmonë i bën me te forta kompanitë dhe as nuk ndihmon te siguruarit.

### **Raporti i Shpenzimit**

69. Raporti i Shpenzimit krahason shpenzimet e kompanisë me primit e kompanisë.
70. Meqenëse kontabiliteti i kompanisë se sigurimit fokusohet ne aftësinë paguese, kompanitë i shlyejnë shpenzimet sapo ato te krijohen. Për me tepër, një pjese domethënëse e shpenzimeve te një kompanie sigurimesh janë te lidhura me kompaninë si një shqetësim permanent. Nëse një kompani ndërpret regjistrimin e bizneseve, e gjitha ajo qe nevojitet është caktimi i një stafi ose i një kontabilisti për te vazhduar likuidimin e kërkesave (kjo zakonisht edhe nënkontraktohet). Ne këtë mënyrë shpenzimet e krijuara përbejnë numëruesin e raportit, edhe nëse ato nuk janë te likuiduara.
71. Shembull: një komision për një prim 1-vjeçar qe paguhet me datën 1 Korrik konsiderohet një shpenzim i krijuar saktësisht me 1 Korrik. Komisioni nuk ndahet ndërmjet këtij viti dhe vitit pasardhës ne te njëjtën mënyrë se si ndahet primi ne te fituar dhe te pafitur. Ky kontabilitet është konservator – shpenzimet njihen menjëherë, ndërkohë qe primi nuk njihet derisa te fitohet. Kontabiliteti konservator është i sakte për kompanitë e sigurimeve pasi është e rëndësishme qe ato te mbeten komani me aftësi paguese.
72. Shpenzimet qe duhen përfshire janë te gjitha ato qe janë krijuar gjate periudhës

kohore, përveç shpenzimeve për investime të cilat merren kundrejt të ardhurave të investimeve dhe shpenzimeve të axhustimit të kërkesave të futura në shumat e parashikuara si rezerve të kërkesave. Për këtë arsye, shpenzimet që do të përfshihen në këtë raport janë komisionet, shpenzime zyre, taksat, etj.

73. Primi i shkruar shërben si emërues sepse shumë prej shpenzimeve janë të lidhura me shitjen, nënshkrimin dhe krijimin e rekordeve për produktet e reja. Kështu që duke përdorur primin e shkruar realisht njihet se niveli i shpenzimeve është gjerësisht i diktuar nga ruajtja e siguruesit si një shqetësim permanent.
74. Përmasa e pritshme e raportit të shpenzimit do të variojë edhe sipas linjës së produktit dhe sipas komisioneve. Një shifër e përafërt mund të ishte 30% deri në 40%, ku përafërsisht gjysma zakonisht ka të bëjë me shpenzimet e shpërndarjes.

### **Raporti i Kombinuar**

75. Raporti i kombinuar është shuma e raportit të kërkesave dhe e raportit të shpenzimeve. Për shembull, nëse në kemi një raport humbje prej 70% dhe një raport shpenzimi prej 30%, atëherë raporti i kombinuar do të jetë 100%.
76. Masa e pritshme e raportit të kombinuar do të variojë sipas linjës së produktit ashtu siç ndodh edhe me pjesët e tij përbërëse. Në rastin e një linje konkurrese produkti në një treg të avancuar sigurimesh, raporti do të jetë rreth 100%, dhe fitimi operativ i siguruesit do të jetë i barabartë me të ardhurën e investimit të fituar mbi asetet që mbulojnë rezervat teknike. Nuk është e pazakonte për një raport të kombinuar të shkojë mbi 100%. Industria e sigurimit të përgjithshëm kalon neper cikle në të cilat konkurrenca i detyron kompanitë të ulin primet në përpjekje për të fituar një pjesë me të madhe tregu. Primet e ulëta shkaktojnë rritjen e raporteve të kombinuara. Eventualisht, gjithsecili po humbet para dhe primet ecin mbrapsht.
77. Për klasat e biznesit me afat të gjatë asetet që mbështesin shumat e parashikuara si rezerve për kërkesat mund të mbahen për periudha të gjata dhe të gjenerojnë të ardhura domethënëse investimi. Në këtë skenar, mbajtja e shumave të parashikuara si rezerve për kërkesat në koston e fundit të vlerësuar të zgjidhjes mund të zmadhojë kostot e kërkesave në fazat e hershme dhe mund të deformatë edhe raportin e humbjes nëse portofoli është duke u rritur ose duke u zvogëluar (nëse qëndron i pandryshuar, zmadhimi eliminohet). Nga ana tjetër, duhet bere kompensimi për të ashtuquajturin rritje të super inflacionit, për shembull, për një ndryshim në qëndrimet gjyqësore. Në disa vende presupozohet se këto shlyejnë njëra-tjetrën dhe vlerësimet finale të kërkesave mbahen në bilanc. Në vende të tjera të ardhurat e investimit lejohen shprehimisht (domethënë, kërkesat zbriten), por nëse kjo behet, atëherë edhe kompensimi duhet bere për efektet e inflacionit.

### **Përfitueshmëria e Kompanisë**

78. Kompanitë e sigurimit te përgjithshëm paraqesin pasqyrat e tyre te fitimit dhe te humbjes duke llogaritur se pari te ardhurat e nënshkruara dhe pastaj duke i shtuar asaj te ardhurën e investimit për te arritur tek fitimi apo humbja ne total.
79. E ardhura e nënshkruar është fitimi i lidhur drejtpërsëdrejti me policat e sigurimit. Është fitimi i nxjerre nga nënshkrimi ose prezumimi i riskut. Llogaritet duke marre primet e fituar dhe duke zbritur kërkesat e bëra dhe te gjitha shpenzimet e përfshira ne raportin e shpenzimit.
80. E ardhura e investimit është një e ardhur e fituar nga investimet pasi zbriten te gjitha shpenzimet e investimit. Duke folur saktësisht mund te themi se e ardhura e investimit qe vjen nga qarkullimet e kesh-it te gjeneruara nga aktiviteti i sigurimit duhen ndare nga e ardhura e investimit mbi asetet e financuara nga fondet e aksionerëve, ne mënyre qe fitimi i vërtete operativ te mund te përlllogaritet.
81. Fitimi ne total përbehet nga fitimet e nënshkruara plus te gjitha te ardhurat e investimit.
82. Shifra e fitimit, e cila është me e rëndësishmja për investitorët, është fitimi mbi investimin. Kapitali i kompanisë dhe teprica është shuma e investuar ne kompani. Cilat janë fitimet te lidhura me këtë shume? Siç duket një kompani me kapital dhe teprice me te madhe duhet te ketë fitime me te mëdha. Si rezultat i fitimit nga investimi apo i fitimit mbi shifrën e kapitalit përbën atë çka është e rëndësishme.
83. Një kompani sigurimi mundet, ne teori, te rrisë fitimet e nënshkruara te saj proporcionalisht me kapitalin dhe me tepricën duke shkruar/regjistruar me shume produkt. Nëse bizneset japin te gjitha fitim, atëherë fitimi proporcional me kapitalin dhe me tepricën do te rritet.
84. Problemi për organin e menaxhimit dhe për rregullatorin është te gjeje balancën e duhur. Sa biznes mund te shkruaje një kompani ne mënyrë te sigurte?
85. Shkrimi i me tepër biznesi, domethënë produkti, jep mundësi me te mëdha për fitime, por kjo sjell edhe mundësi me te mëdha për humbje dhe rritje te riskut te biznesit nëse kapitali nuk rritet. Për sa kohe primi i fituar plus e ardhura përkatëse e investimit tejkalojnë kërkesat dhe shpenzimet e ndryshueshme te shoqëruara prim-et e shkruara, kompania është duke përmirësuar përfitueshmërinë e saj.
86. Limitet ne investime e vogla duhet te vendosen nga te dy, nga organi i menaxhimit dhe rregullatori. Limiti i rregullatorit do te jete maksimumi, por menaxhimi do te ketë limite te ndryshme për secilën linje biznesi, domethënë produkti, dhe për kompaninë ne total. Aksionerët nuk dëshirojnë te humbasin investimin e tyre dhe profili i riskut i kompanisë do te jete një vendim i rëndësishëm i organit te menaxhimit. Sa biznes dëshiron ajo te shkruaje ne secilën linje dhe çfarë standardesh te nënshkrimit dëshiron te imponoje ne secilën linje?

## Raporti i Ndërsjellët i Variablave

87. Fitimi mbi kapitalin e një shoqëri të përgjithshme sigurimesh varet në raportin e saj të kombinuar (rezultatet e saj), shumën e produktit që ajo shkruan mbi një bazë të dhënë kapitali (investimin e saj të vogël për të përfituar të ardhura të mëdha) dhe se sa kohë ajo i mban paratë përpara se t'i paguaje ato për kërkesat. Tabela e mëposhtme bën lidhjen e këtyre koncepteve.

### Fitimi mbi Kapitalin për Raportet e Dhëna Kombinuara dhe mbi Raportet e Dhëna të Prim-it ndaj Kapitalit dhe Tepricës <sup>2</sup>

Shkalla horizontale është raporti i kombinuar  
Shkalla vertikale është prim-i si përqindje (kapital dhe teprice)

	97.5 %	99.0 %	100.5 %	102.0 %	103.5 %	105.0 %	106.5 %	108.0 %	109.5 %	111.0 %
80%	8.5	7.8	7.1	6.4	5.6	4.9	4.2	3.5	2.8	2.1
90%	9.1	8.3	7.5	6.7	5.9	5.1	4.3	3.5	2.7	1.9
100%	9.6	8.7	7.9	7.0	6.1	5.2	4.3	3.4	2.5	1.6
110%	10.2	9.2	8.2	7.3	6.3	5.3	4.3	3.4	2.4	1.4
120%	10.8	9.7	8.6	7.6	6.5	5.5	4.4	3.3	2.3	1.2
130%	11.3	10.2	9.0	7.9	6.7	5.6	4.4	3.3	2.1	1.0
140%	11.9	10.7	9.4	8.2	7.0	5.7	4.5	3.2	2.0	0.7
150%	12.5	11.2	9.8	8.5	7.2	5.8	4.5	3.2	1.9	0.5
160%	13.1	11.6	10.2	8.8	7.4	6.0	4.6	3.1	1.7	0.3
170%	13.6	12.1	10.6	9.1	7.6	6.1	4.6	3.1	1.6	0.1
180%	14.2	12.6	11.0	9.4	7.8	6.2	4.6	3.0	1.4	-0.2

Supozimet: raporti i shpenzimit 28.5%, zgjatja e rezervave të humbjes 1.6 vite, yield-i ekuivalent i taksës 6.0%.

<sup>2</sup> Burimi: V.J. Dowling, Partner Menaxhimi i Letrave me Vlerë i Dowling dhe Partners, LLC në një fjalim në Simpoziumin e mbajtur në Russell Miller Inc 1999, "Problemi i Super Rritjes" i raportuar në Gazetën Russell Miller vol. 11, no. 1, 1999.

## Aneksi 1

### Llogarite e Siguruesit Jojetësor

#### Bilanci

Kesh	5	Rezerve e prim-it te pafituar	50
Asete te investuara	225	Kërkesa te Papaguara ne proces	50
Primet e maturuara & te hyra	15		
Te hyra risigurimi	20	IBNR	100
Asete te tjera	15	Për Risiguruesit	15
		Detyrime te tjera	<u>5</u>
		Rezervat dhe Detyrimet ne total	220
		Paguar ne kapital	20
		Teprice	<u>40</u>
		Kapital dhe teprice ne total	<u>60</u>
Totali	280	Totali	280

88.

### **Kompania e Sigurimit Jojetësor Pasqyra e Fitimit dhe e Humbjes**

#### **Llogaria Teknike**

E ardhur:		
Prim-i bruto i shkruar	300	
Risigurim		<u>150</u>
Prim-i neto i shkruar	150	
Ndryshimi ne prim-in UE		<u>10</u>
Prim-i i Fituar	140	
Humbjet (ose kërkesat)		
Humbjet e paguara	50	
Ndryshimi ne rezervat e humbjes		<u>40</u>
Kërkesa te bëra		<u>90</u>
Rezultati i Sakte U/W	50	
Shpenzimet		
Kostot e Blerjeve (net)	30	
Shpenzime te tjera nënshkrimi		<u>5</u>
Shpenzimet ne total		<u>35</u>
<b>Fitimi ose Humbja e Nënshkruar</b>	<b>15</b>	

#### **Llogaria jo-teknike**

E ardhur investimi	10	
Fitime te realizuara kapitale	5	
Shpenzime investimi		<u>(5)</u>
<b>E ardhura neto e investimit</b>	<b>10</b>	
<b>Fitimi përpara taksës</b>	<b>25</b>	